

854-32

NASHO JORGAQI

7 76



NOVELË

POSTA
E LARGET

8SH-32

7 76



5

NASHO V. JORGAQI

NOVELË


SHKURTË E SHIETË
GJYKËS

~~48321~~

1233

POSTA
E LARGËT

SHËTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»



PROLOG

Posta më e largët e repartit është vendosur në majë të malit, në një pikë të lartë prej ku syri rrok tërë panoramën e asaj krahine të thellë malore.

Mali, nga njëra anë, zbret thikë tatëpjetë mbi një hon të shkretë shkëmbor, plot skërka e bokërina, kurse, nga ana tjetër, i veshur me pyje të rrala e kullota të varfëra vjen e ulet shkallë-shkallë. Në këmbë të tij, i shpërndarë nëpër një luginë të ngushtë, shtrihet fshati më i largët i krahinës.

Posta është një ndërtesë karakteristike ma-

lore, e ngritur me gurë të mëdhenj, në ngjyrë të errët, e mbuluar me plloça që koha i ka nxirë. Nga larg ajo, bashkë me kullën e saj, duket si një zog i ngurtësuar, me kokën lart, i ngulur mbi kreshtën e malit. Kjo bie në sy, veçanërisht në dimër, kur zhvishen drurët, e shkëmbinjtë rreth e qark marrin një ngjyrë gri të mbyllur e mali merr një dukje pak të zymtë, po krenare.

Dimri këndej është i rreptë, me dëborë, stuhi e cingërima dhe herë-herë shtrëngon aqë shumë, sa ngjan sikur te ky kënd i vetëmuar natyra gjen të shfryjë e të buçasë lirisht tërë tekat e saj. Në këtë kohë, strehët e postës e sidomos kulla, që lar-tohet mbi të, uturojnë pareshtur nga zhurma e zëra të çuditshme. Gjithë dimrit mbi këtë majë të vetëmuar shkarkojnë rrufetë, pllakosin stuhitë, gjëmojnë bubullimat, po prapë posta ushtarake as që do t'ja dijë. Ajo qëndron gjithnjë si zogu guximtar që është gati të sulet fluturim në çdo kohë.

Kur vjen pranvera, sado e kursyer, jeta edhe këtu gjallërohet e merr ngjyrat e saj. Pushon suferina e egër dhe zë e fryn një erë e butë, dëborë fillon e shkrin, retë që vareshin gjithë dimrin mbi mal vijnë e ngrihen lart e humbasin në kaltërsinë e qiellit të pranverës. Dalëngadalë, mali vishet, gjelbërojnë drurët, hapin lulet dhe vendi ndërron pamje. Hija e rëndë e malit zbutet. Një gjelbërim i lehtë mbulon faqen e tij mbi fshat. Dëgjohet këndshëm shushurima e rrëkeve tek zbresin tatëpjetë, cicërima e zogjve dhe fëshfëritja e gjetheve të reja ...

Ushtarët që shërbejnë në këtë postë të largët janë mësuar me jetën e vështirë, me trillet e natyrës dhe vetëminë e përhershme. Zakonisht këtu

qëndrojnë dy ushtarë. Dhe ndodh që gjithmonë njëri nga këta është i vjetër e tjetri i ri. Kështu, kur erdhi në këtë pikë ushtar Fatmiri, Xhaferi kish mbushur vitin e parë të shërbimit e po bënte të dytin. Shoku me të cilin kishte shërbyer bashkë ishte lëruar dhe ai, si më i vjetër, kish mbetur komandant poste.

Unë jam ushtar, ç'të jem më shumë?
Kështu pra, siç e shihni,
Mbi supe mbaj kapot' të murme,
Këpucë prej meshini.

Te vendi i rojes, rri e ndjej
Tufan në errësirë,
Por nata dot asgjë s'më fsheh,
Se jam ushtar i mirë.

(«Poema e ushtarit» Dh. Qiriazzi)

I PARI

Fatmiri arriti këtu në mbrëmjen e asaj dite që kish ikur ushtari i liruar. Gjithë atë ditë, Xhaferi kish ndenjtur i mërzhitur, posta i dukej fare e shkretë, nuk i hiqej mendja nga shoku që e kish lënë. Ushtarin e ri pothuaj nuk e njihnte, vetëm se e kish parë për fytyrë në repart. Por, kur atë mbrëmje vjeshte, Fatmiri kish thirrur nga sheshi: «O i zoti i shtëpisë!» dhe ish ndalur në prak të postës dhe aty ata qenë takuar si dy shokë të vjetër, Xhaferi ndjeu padashur se kish rrokur në

qafë gjithë shokët e repartit e se zbraztësia e krijuar do të mbyllej me siguri shpejt. Ai i kish hequr me ngut çantën e shpinës, e kish ulur në krevatin me çarçafë të larë dhe e kish gostitur me çaj e mollë. Fatmirit sepse i qe dukur se kish takuar një njeri të afërt me të cilin kish shumë kohë pa u parë.

Të nesërmen nisi detyra e përbashkët e dy ushtarëve në postën e largët. Xhaferi e ngjiti shokun lart në kullë dhe që andej ata soditën vendin përçark. Dita ishte e kthjellët. Vështrimi i tyre vërtitej sa andej këndeje në të katër anët e horizontit. Poshtë kullës, e zhytur në hapsirën e kaltër, shtrihesh deri në pafundësi zona e postës së tyre. Gjithë ato male e fusha, lumenj e lugina, pyje e hone do t'i ruanin sytë e Xhaferit e të Fatmirit.

Komandanti i postës e çoi pastaj Fatmirin te aparatet, i shpjegoi sinjalet, i tregoi disa nga ngjarjet e jashtëzakonshme që kishin ndodhur në postë. Ushtari dëgjonte, pyeste, provonte me dorën e tij instrumentet.

Dita e parë, sado e lodhshme, kaloi pa u kuptuar. Ushtarin e ri e preku kujdesi i shokut, sjellja e tij e përzëmërt. Po në ditët që erdhën më pas, Xhaferi papritmas sikur ndërroi, u bë njeri i heshur, fliste pak ose, më mirë, nuk fliste si ditët e para. Fatmirit kjo i sëmboi përbrenda dhe përpak desh ja mori për keq. Kujtoi se mos ai ishte i pakënaqur prej punës së tij dhe mendohej ta kryente sa më mirë detyrën. Po dalëngadalë Fatmiri zuri të kuptojë se Xhaferi s'kish ndonjë gjë me të, se kjo ish natyra e tij. Ai sillej mirë, kujdesej për të, bile ndonjëherë e zgjaste shërbimin e vet, për të mos e munduar shokun e ri. Po megjithatë banori i ri i pos-

tës s'e kish kollaj të mësohej. Për kushedi sa ditë, dhe, këto qenë javët e para, atë e mundonte heshtja që e rrethonte gjithandej. I dukej se e kishin hedhur aty në botën e heshtjes e të vetëmisë. Ditët kalonin të plogëta. Atij i vinte t'i thërriste Xhaferit, ashtu kot, pa shkak ose të dilte në majë të kullës e të sokëllinte me të madhe. Si ishte ndarë aq papritmas nga njerëzit, nga jeta plot gjallëri e repartit! Ai ishte mësuar t'i binte kryq e tërthor shesheve të gjera të qytezës ushtarake. Në vesh i kumbonin akoma zërat e dashur të shokëve, zhurma ritmike e hapit të togës. Nga sytë e tij s'qenë zhdukur edhe shumë skena të një jete të kaluar në mes gjithë atyre njerëzve.

Koha në repart rridhte shpejt, e gjallë, kurse, në postë, sikur i ngjitej me zor të përpjetës së mallit e i qëndronte Fatmirit mbi kokë. Kjo gjë e bënte këtë të ndrojtur dhe, padashur, e hutonte; e hutonte, sidomos ajo heshtje e madhërishme që ndehet mbi mal, mbushte dhomat e postës, shtrihej nëpër sheshin e shkretë, e varej natë e ditë mbi kullë. Për herë të parë këtu, ai ndjeu pushtetin e heshtjes, mësoi të dallojë zhurmat e holla, njohu pak nga pak gjuhën e tyre. Në repart, kjo gjë do t'i dukej qesharake, po, këtu në postë, Fatmiri nga dita në ditë mësoi ta njohë hapin e prerë të Xhaferit. Dhe hapat e Xhaferit s'ishin një gjë e kotë, po thoshin diçka, kishin një kuptim në një orë të caktuar të ditës a të natës.

Xhaferi që e kish kuptuar me kohë këtë gjendje që po kalonte shoku i tij, me qëllim nuk e shqetësonte. E dinte se kjo ishte si puna e njeriut që, kur futet në fillim në ujë, ka pak të dridhura, po pastaj vjen e mësohet. Se në fund të fundit, ai

s'kish ç'ti bënte për t'i ardhur në ndihmë. Detyra e tyre kështu e kish, të qëndronin veç shokëve, në majë të malit, po me mendje të mbledhur dhe në gatishmëri të plotë.

Ato ditë Xhaferi e shikonte Fatmirin dhe, duke buzëqeshur, ja bënte:

— Do të kalojë shpejt, Fato, dhe do të mësohesh si unë.

— Dreqi ta hajë! U mësova keq me repartin — ja priste Fatmiri, duke mos e shikuar shokun në sy.

— Po dhe ne repart jemi këtu!

— Repart me dy veta? — thoshte me duf tjetri — Lërmë, aman!

— Po, po, bile shumë i rëndësishëm. E kam seriozisht. Po nuk u binde për këtë, nuk do ta kesh kollaj të mësohesh!

Këto fjalë ushtarit të ri s'iu hoqën nga mendja për një kohë të gjatë.

«Po nuk u binde për këtë, nuk do ta kesh kollaj të mësohesh!»

Kështu ikën muajt e parë. Pas kësaj, ai s'ndjeu më nevojë t'i qaj Xhaferit. Erdhi një kohë që ushtari i ri u mësua me heshtjen, s'i bënte aq përshtypje vetëmia. Fatmiri iu shtrua detyrës sikur të ishte në repart, si të jetonte e të shërbente atje në mes shokëve të togës. Ai ngjite shkallët e kullës në mbrëmje, sapo binin hijet e para dhe zbriste poshtë në mesnatë ose ndodhte e kundërta. Flinte deri në mesnatë e pastaj e zgjonte Xhaferi. Ditën ata pushonin me rradhë dhe stërviteshin, si mund të stërviten dy veta. Në detyrë ishin të heshtur. Veprimet i bënin pa zhurmë, qetë e qetë, duke shkëmbyer më të rrallë ndonjë fjalë. Herë e herë merreshin vesh me gjeste e me të fërshëllitur e në këto raste ishin

krejt të panevojshme fjalët. Detyra që ata kryenin kërkonte vëmendje të madhe, seriozitet, mendim të matur. Ajo nuk i duronte fjalët e tepërta, muhabetet kot së koti, shakatë pa kuptim. Fatmiri për këtë u bë i ndërgjegjshëm shpejt dhe, në shërbim e sipër, tregohej mjaft i vëmendshëm e i aftë. Po megjithëse u mësua me jetën e veçantë të postës, sado i heshtur e i duruar që u bë, prapë nuk e ndryshoi natyrën e tij.

Si natyra, Fatmiri dhe Xhaferi qenë të ndryshëm. Xhaferi vinte i mbyllur, kishte fjalë pak, ishte mjaft i matur, kurse Fatmiri ishte i çelur, shpeshherë i gëzuar, i pëlqente më shumë të fliste se sa të rrinte gojëkyçur. Po megjithatë, kjo nuk i ndalonte dy shokët të merrëshin vesh e të shkonin mirë me njëri-tjetrin.

Njëherë, Fatmiri, kur qenë bërë shokë të afërt, i tha Xhaferit: «Ore, ç'është kjo kështu? Fjalët e tua i them unë, heshtjen time e mban ti! Hajde t'i trazojmë se s'ka lezet!»

Xhaferi qeshte dhe s'dinte si t'i përgjigjej. Atë çast fytyra e tij e gjerë, me ata sy të mëdhenj e mjekrën e ashpër që i ngjante gjithnjë e parruar, shkëlqente nga një gaz i çiltër. Ai ishte një prej atyre njerëzve që nuk qeshin kollaj, por, kur qeshte, i binte një nur fisnik, aq sa ta kish ënda ta shikoje. Megjithatë, në këso rastesh Fatmiri rrudhte sytë që i kish në trajtë bajameje dhe e vështronte shokun me ngulm, si të donte me këtë ta qortonte. Ai ishte i dëshëruar që shoku i tij i vetëm të fliste e të fliste pa pushim.

Po kishte ditë dhe kjo, sigurisht, ndodhte më të rrallë, që i binte në qafë Xhaferi Fatmirit. Sa herë merrte ndonjë letër a kur kthehej nga reparti,